KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 4190 Prot.
Datë, më 25 04 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1670 prot. Tiranë, më 25.04.2023

**Lënda**: Përcillet vendimi i AMA-s mbi monitorimin e fushatës zgjedhore për periudhën 14-22 prill 2023

**Z. ILIRJAN CELIBASHI,**
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
*Adresa:* Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në cilësinë e autoritetit rregullator që monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit audioviziv (OSHMA), sipas neneve 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar, si dhe në zbatim të dispozitave të vendimit nr 2,datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ "*Mbi metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive*", përcjell në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- Vendimin e AMA nr 26, datë 25.04.2023 "*Për shqyrtimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 prill 2023*".
- Tabelat përmbledhëse për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në periudhën 14-22 prill 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Ronelda RRAPOLLARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Nr 1663 prot., Tiranë, më 25.04.2023

**VENDIM**

**NR. 26, DATË 25.04.2023**

**PËR**
**SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË MBULIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË PËR PERIUDHËN 14-22 PRILL 2023**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i përbërë nga:

| | | |
|---|---|---|
| Armela | Krasniqi | Kryetar |
| Desada | Metaj | Zëvendëskryetar |
| Aurela | Bicja | Anëtar |
| Besian | Zogaj | Anëtar |
| Gjergji | Hamiti | Anëtar |
| Jetmir | Halilaj | Anëtar |
| Joana | Allushi | Anëtar |

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

**Kërkues:** AMA, kryesisht

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 prill 2023

**Bazë ligjore:** Neni 19, pika 16 e ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013 "*Për mediat audiovizive në RSH*", i ndryshuar, nenet 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "*Kodi Zgjedhor i Republikës*

*së Shqipërisë"*, të ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator të KQZ-së *"Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive"*.

**VËREN SE:**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *"Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 2 të KQZ-së *"Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive"*, datë 30.01.2021, është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore.

Sipas pikave 1-4 të nenit 85 të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar:
*1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.*
*2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ të KQZ-së nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.*
*3. Jo me vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.*
*4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.*

Gjithashtu, sipas neneve 9 dhe 10 të Metodologjisë, përcaktohet se raportet e monitorimit të realizuara nga AMA do t'i paraqiten KQZ-së. Sipas pikës 2 të nenit 10 të po këtij akti, parashikohet se *"AMA i pasqyron gjetjet e tij në raporte të detajuara sasiore dhe cilësore, minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë"*.

Përpara fillimit të fushatës zgjedhore, AMA njoftoi OSHMA-të për t'u kujtuar rëndësinë e zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, përmes publikimit në faqen zyrtare të Autoritetit, si dhe dërgimin në adresat e redaksive të të gjitha subjekteve.

Bazuar në kapacitetet ekzistuese teknike të AMA-s, është kryer monitorimi i përmbajtjeve audio dhe audiovizive të 24 OSHMA-ve me karakter gjeneralist dhe informativ.

**Tabela I**

| Nr. | Gjeneralistë |
|---|---|
| *1.* | Rtsh 1 HD |
| *2.* | Rtsh 2 HD |
| *3.* | Tv Klan HD |
| *4.* | Top Channel HD |
| *5.* | Vizion + HD |
| *6.* | Abc News HD |
| *7.* | A2 CNN |
| *8.* | Euronews Albania |
| *9.* | Syri Tv |
| *10.* | Shijak Tv |
| *11.* | Rtv Ora |
| *12.* | Tv Scan |
| *13.* | MCN Tv |
| *14.* | Klan Plus |

**Tabela II**

| Nr. | Informativë |
|---|---|
| *1.* | Fax News |
| *2.* | News 24 |
| *3.* | Report Tv |
| *4.* | Tv Ora News |
| *5.* | Panorama Tv |
| *6.* | CNA Tv |
| *7.* | Rtsh 24 HD |
| *8.* | Top News |
| *9.* | Klan News |
| *10.* | Kanali 7 News |

**Tabela III**

| Nr. | Subjekt audio |
|---|---|
| *1.* | Radio Tirana |
| *2.* | Top Radio |
| *3.* | Radio Klan |
| *4.* | Radio "Club FM" |

Këto 24 OSHMA janë në monitorim të përhershëm, për të cilat është njoftuar KQZ-ja nëpërmjet shkresës së AMA-s nr. 1516 prot., datë 11.04.2023. Po në këtë shkresë, AMA ka njoftuar edhe për 29 OSHMA të tjera, monitorimi i të cilave po bëhet me përzgjedhje javore.

Më poshtë gjendet edhe lista e OSHMA-ve të monitoruara në javën e parë të fushatës zgjedhore, në datat 14-20 prill 2023.

**Tabela IV**

| Nr. | Kanali | Zonë mbulimi |
|---|---|---|
| *1.* | Rtsh Kukësi | Kukës |
| *2.* | Tv Apollon | Fier |
| *3.* | Tv 6+1 Vlora | Vlorë |
| *4.* | Tv Rozafa | Shkodër |
| *5.* | Tv Sot 7 | Pogradec |
| *6.* | Tv Gold Johaniter | Shijak |
| *7.* | Glob Tv | Berat |

Në bazë të Metodologjisë së sipërcituar, gjatë kësaj periudhe, AMA ka përcjellë raportet ditore të monitorimit për këto OSHMA, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Kohën e monitorimit të secilit OSHMA, për transmetimet në orën 08.00-24.00;
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor;
- Hapësirën për çdo subjekt politik;
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative;
- Transmetimet e drejtpërdrejta (*live*);
- Raportin gjinor sa i takon mbulimit mediatik të kandidatëve.

## I. Pasqyrimi i aktiviteteve të shpallura "Ndaluar nga KQZ":

Prej datës 14.01.2023, AMA, filloi angazhimin për monitorimin e veprimtarive të institucioneve publike të konsideruara si të ndaluara nga KQZ. Deri më datë 22.04.2023, AMA ka pritur 9 (nëntë) njoftime nga KQZ, të cilat përmbanin vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ndalimin e veprimtarive, që ishin shpallur "Ndaluar nga KQZ".

Vendimi i Komisionerit bazohet në nenin 9, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, sipas të cilit AMA "të marrë masa që mos të lejohet transmetimi apo të pasqyrohet në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione".

Vendimet e adresuara në AMA nga KQZ ishin:

- Vendim nr. 190, datë 21.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Gjirokastër";
- Vendim nr. 191, datë 21.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Kulturës";
- Vendim nr. 197, datë 23.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale";
- Vendim nr. 204, datë 24.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Memaliaj";
- Vendim nr. 212, datë 28.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Bashkisë Lushnjë";
- Vendim nr. 213, datë 28.03.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Cërrik Ujësjellës Kanalizime Cërrik";
- Vendim nr. 231, datë 31.03.2023, "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Korçë";
- Vendim nr. 356, datë 14.04.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Belsh";
- Vendim nr. 367, datë 15.04.2023 "Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Tiranë".

Me njohjen e vendimeve të KQZ, AMA menjëherë ka njoftuar të gjitha OSHMA-të me përmbajtjen e tyre, duke ia nisur me email, si dhe duke i shkarkuar të plota këto vendime në faqen zyrtare të Autoritetit. Nga monitorimi i përmbajtjeve të transmetuara nuk u identifikua asnjë rast pasqyrimi nga OSHMA-të të aktiviteteve që KQZ ka konsideruar si të ndaluara.

## II. Depozitimi i regjistrimeve në AMA:

Pika 6 e nenit 85 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, parashikon se *radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të saj.*

Detyrimi për depozitimin ditor të përmbajtjeve audiovizive parashikohet edhe në metodologjinë e monitorimit të medias të sipërcituar, ku thuhet se "*OSHMA-të **vendore** që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese*".

OSHMA-të si Glob TV; Channel 7; Klaudiana TV dhe Saranda TV, nuk kanë paraqitur regjistrimet pranë AMA-s nga data 14 deri në datë 22 prill 2023.

**Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.**

Gjithashtu, AMA informon se OSHMA-të TV Berati, nuk i ka sjellë regjistrimet në datat 14, 15 dhe 16 prill 2023; TV Alpo nuk i ka sjellë në datat 14, 15,16 dhe 18 prill 2023; Bulqiza TV nuk i ka sjellë në datat 14 dhe 16 prill 2023; TV Mati nuk i ka sjellë në datat 15 dhe 16 prill 2023.

**Propozim:**

**AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të mësipërme për respektimin e plotë të këtij detyrimi.**

## III. Të dhënat mbi edicionet informative:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 81 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, i cili parashikon se: "*në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik (RTSH) është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend*". I njëjti parashikim zbatohet edhe për OSHMA-të private.

**Në Tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 1 bashkëlidhur**, pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike e pasqyruar në edicionet informative të subjekteve audio dhe audiovizive që janë në monitorim të përhershëm, përgjatë periudhës 30 ditore të fushatës zgjedhore. që përfshin datat 14-22 prill 2023.

**Propozim:**

**Referuar të dhënave sipas Tabelës nr. 1 në Aneksin 1, për edicionet informative, AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të sipas mbulimit konkret që i kanë bërë fushatës në periudhën 14-22 prill 2023, të bëjnë në vijim kompensimin në kohë transmetimi, në edicionet informative për efekt balancimi.**

OSHMA-të duhet t'i referohen edhe përmbajtjes së shkresës nr. 3710 prot., datë 12.04.2023, që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u ka dërguar "*Mbi disa rregulla që duhet të zbatohen nga operatorët radiotelevizivë privatë gjatë fushatës zgjedhore*".

**Në Tabelën nr. 1/1 të Aneksit nr. 1 bashkëlidhur, jepen të dhëna mbi kohën e sinkroneve (në edicionet e lajmeve) të protagonistëve të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në monitorim të përhershëm.**

**IV. Të dhënat mbi emisionet:**

**Në Tabelën nr. 2, të paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur**, jepen të dhënat përmbledhëse për periudhën 14-22 prill 2023, mbi kohën që iu kanë dhënë OSHMA-të në monitorim të përhershëm subjekteve politike në emisione dedikuar fushatës zgjedhore në fjalë.

**V. Të dhënat mbi reklamën politike:**

Në mbështetje të pikave 4-5 dhe 7 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, parashikohen kriteret ligjore për transmetimin e reklamës politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Ky nen parashikon se "4. *Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklamat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë."*

*5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje...*

*7. Reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15.00 deri 18.00 dhe nga ora 21.00 deri 24.00 të programit ditor."*

**Në Tabelën nr. 3 të Aneksit nr. 1 bashkëlidhur**, jepen të dhënat përmbledhëse mbi transmetimin e reklamave politike prej OSHMA-ve gjatë periudhës 14-22 prill 2023.

Më poshtë, prezantojmë OSHMA-të cilat kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

OSHMA-të si Syri TV, Shijak TV dhe TV Apollon, kanë transmetuar reklamë politike jashtë orarit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Konkretisht:

- Syri TV – datë 14 prill (14 herë) dhe datë 15 prill (6 herë);
- Shijak TV - datë 15 prill (2 herë), datë 18 prill (1 herë), datë 20 prill (4 herë), datë 21 prill (5 herë), datë 22 prill (3 herë);

- TV Apollon – datë 16 prill (1 herë).

AMA, në raportet ditore, ka raportuar në KQZ oraret konkrete të transmetimit të reklamave politike jashtë kohës së lejuar.

<u>**Propozim:**</u>
**AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike në kohën e ndaluar.**

### VI. Të dhëna mbi raportimin e përfaqësimit gjinor në fushatë:

**Tabela nr. 4 e Aneksit nr. 1 (bashkëlidhur),** pasqyron përmbledhtazi vlerësimin gjinor në përmbajtjet audiovizive të monitoruara e të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën zgjedhore gjatë periudhës 14-22 prill 2023.

<u>**Propozim:**</u>
**AMA i propozon KQZ-së që t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.**

### VII. Të dhënat mbi transmetimet e drejtpërdrejta (live):

Në tabelën nr. 5 të Aneksit 1 (bashkëlidhur), jepen të dhëna mbi transmetimet e e drejtpërdrejta (live) që kanë lidhje me fushatën zgjedhore në periudhën 14-22 prill 2023.

### VIII. Monitorimi i përkohshëm i OSHMA-ve:

Në vijim të Aneksit nr. 1, bashkëlidhur, jepen tabelat për monitorimin 1 javor (14-20 prill 2023) të OSHMA-ve me përzgjedhje të përkohshme, si sipërpërmendur.

Edhe për këto OSHMA, AMA ka përcjellë çdo ditë në KQZ, raportet përkatëse të monitorimit, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Kohën e monitorimit të secilit OSHMA, për transmetimet në orën 08.00-24.00;
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor;
- Hapësirën për cdo subjekt politik;
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative;
- Transmetimet e drejtpërdrejta (*live*);
- Raportin gjinor sa i takon mbulimit mediatik të kandidatëve.

Në datën 21 prill 2023, ka filluar monitorimi për javën e dytë të OSHMA-ve të përzgjedhura.

**PËR KËTO ARSYE:**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr 97/2013, 19/03/2013, datë "Për mediat audiovizive në RSH", i ndryshuar, nenet 77-85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit nr.2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator të KQZ-së "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive",

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit të AMA-s së mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 prill 2023.
2. T'i rekomandojë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:
   i. Të procedojë me marrje mase administrative, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, për OSHMA-të që nuk kanë paraqitur asnjë regjistrim pranë AMA-s nga data 14 deri në datë 22 prill 2023.
   ii. Të procedojë me tërheqje vëmendje për OSHMA-të që nuk kanë respektuar plotësisht detyrimin e paraqitjes së regjistrimeve të plota pranë AMA-s nga data 14 deri në datë 22 prill 2023.
   iii. Të kërkojë prej OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimeve të reklamave politike në kohën e ndaluar, sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.
   iv. Të procedojë me tërheqje vëmendje për OSHMA-të përkatëse, për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për njoftimin e këtij vendimi pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| **Kryetar:** | **Armela** | **KRASNIQI** |
| **Zëvendëskryetar:** | **Desada** | **METAJ** |
| **Anëtarë:** | **Aurela** | **BICJA** |
| | **Besian** | **ZOGAJ** |
| | **Gjergji** | **HAMITI** |
| | **Jetmir** | **HALILAJ** |
| | **Joana** | **ALLUSHI** |

**Autoriteti Mediave Audiovizive**
**Subjekti - Lajme**
**Koha e plotë në minuta**
**14/04/2023 - 22/04/2023**
**OSHMA me monitorim të përhershëm**
**TABELA NR. 1**

| Subjekti | CNA | Kanali 7 | Klan News | Syri Tv | Panorama Tv | Top News | A2 CNN | Abc News | Shijak TV | News 24 | Report TV | Ora News |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BF Bashkë Fitojmë | 692.52 | 307.52 | 255.05 | 669.8 | 394.88 | 153.18 | 196.82 | 69.67 | 473.98 | 222.9 | 45.83 | 140.03 |
| PS Partia Socialiste | 597.77 | 384.58 | 247.8 | 52.82 | 113.67 | 295.12 | 201.17 | 161.68 | 0 | 62.85 | 110.6 | 99.2 |
| PD Partia Demokratike | 421.73 | 227.07 | 190.1 | 4.35 | 151.8 | 144.4 | 110.48 | 133.07 | 0 | 80.33 | 118.17 | 52.13 |
| KQZ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve | 159.68 | 186.77 | 174.4 | 54.83 | 64.62 | 64.27 | 60.67 | 107.62 | 13.33 | 62.77 | 87.37 | 38.08 |
| PR Partia Republikane Shqiptare | 43.65 | 0 | 47.02 | 25.77 | 29.12 | 1.4 | 14.1 | 6.47 | 0 | 11.17 | 6.42 | 19.7 |
| PDIU Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 23.33 | 0 | 17.78 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17.6 | 0 | 11.12 | 10.53 | 0 |
| PSD Partia Social Demokrate | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| NTH Nisma Thurje | 0 | 0 | 0 | 0 | 11.78 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.08 | 3.1 | 5.67 |
| LZHK Lëvizja për Zhvillim Kombëtar | 0 | 0 | 0 | 3.73 | 0 | 1.65 | 1.4 | 2.7 | 0 | 0 | 0 | 1.07 |
| PAA Partia Agrare Ambientaliste | 0 | 0 | 0 | 3.27 | 0 | 1.5 | 0.65 | 2 | 0 | 1.3 | 0 | 1.07 |
| PKSH Partia Komuniste e Shqipërise | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kolegji Zgjedhor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7.37 | 0 | 0 |
| BD Partia Bindja Demokratike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.55 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PFM Partia Fronti i Majtë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PLB Partia Lëvizja Bashkë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| PMEGA Partia Minoriteti Etnik Grek për të A | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | | | | | |
| Totali | 1938.7 | 1105.9 | 932.15 | 814.6 | 765.87 | 661.52 | 586.49 | 502.36 | 487.31 | 462.89 | 382.02 | 356.95 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE SEKRETARIA

**Autoriteti Mediave Audiovizive**
**Subjekti - Lajme**
**Koha e plotë në minuta**
**14/04/2023 - 22/04/2023**
**OSHMA me monitorim të përhershëm**
**TABELA NR. 1**

| Fax News | Klan Tv | RTSH 24 | RTSH 1 | Rtv Ora | Vizion Plus | Euronews | MCN | Top Channel | Klan Plus | Radio Tirana | Top Albani | RTSH 2 | Radio Klan | Club Fm | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 76.72 | 87.52 | 20.78 | 41.73 | 61.4 | 49.65 | 40.92 | 51.75 | 27.12 | 29.2 | 8.2 | 4.08 | 2.7 | 2.27 | 0.52 | 4126.76 |
| 83.67 | 92.93 | 83.45 | 91.05 | 55.52 | 64.4 | 49.43 | 26.45 | 56.02 | 29.5 | 20.25 | 11.58 | 12.53 | 1.2 | 0.92 | 3006.16 |
| 65.47 | 42 | 14.62 | 35.1 | 28.7 | 39.38 | 46.83 | 41.23 | 22.3 | 17.13 | 18.35 | 4.83 | 0 | 0.3 | 0.53 | 2010.4 |
| 60.27 | 30.87 | 115.78 | 16.48 | 25.78 | 19.48 | 22.87 | 19.62 | 14.43 | 14.9 | 9.15 | 1.48 | 1.65 | 1.3 | 0.27 | 1428.74 |
| 6.5 | 0 | 1.27 | 6.22 | 7.75 | 0 | 5.9 | 0 | 0 | 6.12 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 238.58 |
| 1.4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 82.76 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.2 |
| 3.4 | 0 | 0 | 0 | 2.37 | 0 | 0 | 2.08 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 31.48 |
| 4.8 | 0 | 0 | 0 | 1.55 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 16.9 |
| 1 | 0 | 0 | 0 | 0.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11.54 |
| 0.58 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.58 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7.37 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.55 |
| 0.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.75 |
| 0.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.75 |
| 0.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.75 |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| 306.06 | 253.3 | 235.9 | 190.6 | 183.82 | 172.91 | 166.95 | 141.1 | 119.87 | 96.85 | 55.95 | 21.97 | 16.88 | 5.07 | 2.24 | 10966.3 |

**Autoriteti Mediave Audiovizive**
**Aktori - Lajme**
**Koha sinkron në minuta**
**14/04/2023 - 22/04/2023**
**OSHMA me monitorim të përhershëm**

**TABELA NR. 1/1**

| Aktori | CNA | Kanali 7 | Panorama Tv | Syri Tv | A2 CNN | Klan News | Shijak TV | Top News |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sali Berisha | 133.7 | 95.37 | 100.03 | 111.5 | 58.35 | 66.87 | 80.82 | 44.23 |
| Erion Veliaj | 172.2 | 90.25 | 42.75 | 0.82 | 107.92 | 60.2 | 0 | 66.9 |
| Enkelejd Alibeaj | 132.9 | 117.55 | 52.68 | 4.35 | 47.08 | 65.37 | 0 | 41.68 |
| Belind Këlliçi | 99.93 | 48.05 | 10.45 | 55.97 | 31.1 | 19.43 | 64.02 | 14.17 |
| Edi Rama | 49.42 | 56.75 | 15.02 | 13.78 | 14.4 | 22.07 | 0 | 23.05 |
| Ilir Meta | 36.08 | 12.37 | 38.58 | 19.32 | 15.08 | 5.68 | 34.05 | 2.33 |
| Roland Bejko | 25.67 | 19.15 | 12.27 | 0 | 8.98 | 24.17 | 0 | 11.65 |
| Ilirjan Celibashi | 21.13 | 11.5 | 0 | 0 | 10.62 | 15.1 | 0 | 4.83 |
| Fatmir Mediu | 9.15 | 0 | 18.02 | 8.75 | 11.27 | 16.88 | 0 | 0.65 |
| Ledina Mandia | 13.75 | 0 | 13.38 | 5.37 | 0 | 0 | 6.7 | 0 |
| Luçiano Boçi | 14.8 | 0 | 16.67 | 3.27 | 0 | 0 | 26.62 | 0 |
| Damian Gjiknuri | 21.43 | 0 | 0 | 0 | 4.58 | 0 | 0 | 18.67 |
| Gazmend Bardhi | 14.85 | 8.27 | 14.08 | 0 | 0 | 2.17 | 0 | 6.17 |
| Bardh Spahia | 10.8 | 0 | 1.67 | 16.8 | 0 | 3.9 | 34.3 | 0 |
| Belinda Balluku | 29.2 | 4.67 | 0 | 0 | 3.42 | 0 | 0 | 7.95 |
| Ogerta Manastirliu | 23.38 | 9.2 | 0 | 0.67 | 0 | 1.52 | 0 | 2.33 |
| Emiriana Sako | 21.4 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5.6 |
| Delinda Ibrahimaj | 13.15 | 0 | 0 | 0 | 9 | 6.07 | 0 | 3.17 |
| Floriana Garo | 24.55 | 0 | 7.52 | 8.42 | 0 | 0 | 12.27 | 0 |
| Bledi Çuçi | 25.13 | 14 | 0 | 0.8 | 0 | 1.95 | 0 | 6 |
| Silvi Bardhi | 22.92 | 0 | 0 | 5.63 | 0 | 0 | 16.4 | 0 |
| Evis Kushi | 7.37 | 10.8 | 0 | 1.47 | 0 | 3.25 | 0 | 2.5 |
| Mirela Karabina | 11.92 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.1 |
| Ivi Kaso | 0 | 4.97 | 7.42 | 8.75 | 0 | 0 | 8.75 | 0 |
| Gledian Llatja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17.53 |
| Miftar Dauti | 0 | 0 | 13.6 | 8.75 | 3 | 0 | 0 | 4.9 |
| Shpëtim Idrizi | 5.33 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2.8 | 0 | 0 |
| Igli Cara | 0 | 0 | 8.87 | 5.4 | 0 | 0 | 14.7 | 0 |
| Jorgo Goro | 0 | 23.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Taulant Balla | 3.7 | 0 | 2.12 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13.77 |
| Hysni Sharra | 0 | 20.8 | 0 | 0.27 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ermal Dredha | 0 | 17.07 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ervin Salianji | 0 | 0 | 11.2 | 1.4 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Eriselda Çelaj | 18.18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.5 | 0 | 0 |
| Akil Kraja | 0 | 0 | 0 | 3.13 | 0 | 0 | 7.8 | 0 |
| Pranvera Rizaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Klevis Balliu | 9.15 | 0 | 0 | 1.08 | 0 | 0 | 0 | 2.4 |
| Gledian Llataj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Albana Vokshi | 0 | 0 | 1.8 | 2.2 | 0 | 0 | 4 | 0 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE SEKRETARIA

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Armando Subashi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Arjan Hoxha | 0 | 0 | 1.63 | 8.67 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mateo Spaho | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dashamir Shehi | 0 | 0 | 0 | 1.4 | 1.2 | 0 | 0 | 0.9 |
| Fredi Beleri | 0 | 0 | 0 | 8.88 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Endri Shabani | 0 | 0 | 3.97 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mirela Kumbaro | 0 | 0 | 0 | 1.95 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Benet Beci | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zija Ismaili | 0 | 0 | 0 | 4.2 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| Indrit Hoxha | 0 | 0 | 0 | 3.47 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fatmir Xhafaj | 0 | 0 | 5.67 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Edvar Kodheli | 0 | 0 | 0 | 5.3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Lajla Përnaska | 4.95 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Agron Malaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 5.35 | 0 | 0 | 0 |
| Pano Soko | 0 | 0 | 2.68 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Agron Duka | 0 | 0 | 0 | 0.88 | 0.45 | 0 | 0 | 0.7 |
| Beqir Mulaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.75 |
| Myslim Murrizi | 0 | 0 | 0 | 3.98 | 0 | 0 | 0.33 | 0 |
| Ismail Uka | 0 | 0 | 0 | 0.33 | 3.97 | 0 | 0 | 0 |
| Rahim Spahiu | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.87 | 0 | 0 | 0 |
| Ilda Dhori | 0 | 0 | 0 | 3.8 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tritan Shehu | 0 | 0 | 0 | 2.33 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Skënder Gjuci | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.4 | 0 | 0 | 0 |
| Rakip Suli | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sotiraq Filo | 0 | 0 | 0 | 3.28 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mesila Doda | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.95 | 0 | 0 |
| Arben Cuko | 0 | 0 | 0 | 2.7 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Orjola Pampuri | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Safet Gjici | 0 | 0 | 0 | 2.48 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ilir Mehmeti | 0 | 0 | 0.78 | 1.67 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tomor Alizoti | 0 | 0 | 0 | 1.77 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Redjan Krali | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dashnor Sula | 0 | 0 | 2.23 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ervin Demo | 0 | 0 | 0 | 0 | 2.2 | 0 | 0 | 0 |
| Fisnik Qosja | 0 | 0 | 1.63 | 0.43 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zef Hila | 0 | 0 | 0 | 1.4 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Mariglen Disha | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vangjel Dule | 0 | 0 | 0 | 1.67 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Albert Mëlyshi | 0 | 0 | 0 | 1.62 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Suzana Topi | 0 | 0 | 0 | 1.6 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ulsi Manja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pjerin Ndreu | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Thanas Maneka | 0 | 0 | 0 | 1.42 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Eduard Sharka | 0 | 0 | 0 | 0.6 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Adriatik Spahiu | 0 | 0 | 1.25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ledina Alolli | 0 | 0 | 0 | 1.25 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fabian Topollaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Zini Tollozhina | 0 | 0 | 0 | 1.17 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Alfred Lela | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ilir Alimehmeti | 0 | 0 | 0 | 1.08 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Grisejda Myslimi | 0 | 0 | 0 | 1.05 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Monika Kryemadhi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Luan Baçi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Edison Memolla | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Admir Sinamati | 0 | 0 | 0 | 0.3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Saimir Korreshi | 0 | 0 | 0 | 0.5 | 0 | 0 | 0.25 | 0 |
| Leonard Rakipaj | 0 | 0 | 0 | 0.73 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Edmond Spaho | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kristjan Shkreli | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Preç Zogaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pashk Gjoni | 0 | 0 | 0 | 0.47 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shkëlqim Hoxha | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Petref Skënderaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dorjan Lani | 0 | 0 | 0 | 0.3 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ilir Metaj | 0 | 0.3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Fatmir Gjoci | 0 | 0 | 0 | 0.28 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Greta Badeli | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | |
| Totali | 976.1 | 564.82 | 407.97 | 360.8 | 347.24 | 319.88 | 311.01 | 306.93 |

**Autoriteti Mediave Audiovizive**
**Aktori - Lajme**
**Koha sinkron në minuta**
**14/04/2023 - 22/04/2023**
**OSHMA me monitorim të përhershëm**

**TABELA NR. 1/1**

| Abc News | News 24 | Ora News | Report TV | Fax News | RTSH 24 | RTSH 1 | Vizion Plus | Klan Tv | Rtv Ora |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8.47 | 51.3 | 21.25 | 3.5 | 11.12 | 5.07 | 11.08 | 16.68 | 19.55 | 10.92 |
| 22.92 | 17.55 | 0 | 39.7 | 19.3 | 6.55 | 14.73 | 17 | 16.53 | 0 |
| 34.12 | 29.73 | 23.85 | 22.85 | 22.47 | 4.6 | 10.18 | 17.87 | 9.73 | 13.57 |
| 14.52 | 6.12 | 13.82 | 0 | 4.73 | 3.23 | 4.55 | 5.5 | 8.62 | 8.77 |
| 28.8 | 4.48 | 12.5 | 13.27 | 5.43 | 5.3 | 10.65 | 7.67 | 9.7 | 4.57 |
| 3.68 | 14.87 | 2.5 | 9.67 | 1.3 | 3.08 | 5.27 | 1.5 | 0.6 | 1.78 |
| 14.75 | 8.85 | 3.65 | 19.67 | 5.9 | 0.43 | 2.93 | 3.97 | 3.33 | 1.65 |
| 23.78 | 0 | 8.87 | 17.47 | 0 | 21.35 | 0 | 0 | 3.42 | 0 |
| 1.8 | 1.63 | 9 | 1.4 | 0 | 0.55 | 3.25 | 0 | 0.62 | 3.65 |
| 0 | 7.05 | 27.1 | 0 | 7.33 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.75 |
| 0 | 11.32 | 1.68 | 2.77 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.5 |
| 1.4 | 3.67 | 7.12 | 0 | 4.83 | 0.53 | 4.72 | 0 | 1.85 | 7.7 |
| 0.92 | 0 | 2.7 | 10.5 | 1.27 | 2.1 | 4.2 | 1.6 | 0.92 | 0.9 |
| 0 | 0.93 | 0 | 4.03 | 0 | 0 | 0.35 | 0 | 0 | 0 |
| 10.47 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.8 | 0.58 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 1.45 | 0 | 0 | 14.13 | 4.73 | 1.53 | 0 | 0.17 |
| 16.3 | 0 | 0 | 11.58 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 1.67 | 3 | 0 | 0 | 10.73 | 2.97 | 0 | 1.67 | 0.27 |
| 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.08 | 0 |
| 0 | 0 | 0.82 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.7 | 0 | 0.12 |
| 0 | 0 | 2.93 | 0.97 | 0.87 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.4 |
| 0 | 0 | 3.75 | 0 | 0 | 13.13 | 4.32 | 1.8 | 0 | 0.17 |
| 5.33 | 5.33 | 2.67 | 4.22 | 1.33 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.32 |
| 0 | 4.32 | 1.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.87 | 0.95 | 0.93 |
| 5.07 | 0 | 4.58 | 0.93 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9.37 |
| 0 | 1.6 | 0.83 | 0 | 1.13 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 11.6 | 8.37 | 0 | 5.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 4.25 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.47 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 1.25 | 0 | 0 | 0 | 2.75 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 4.93 | 0 | 0 | 0 | 1.73 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 1.2 | 0 | 0 | 0 | 2.5 | 0 | 0.4 |
| 2.77 | 0 | 1.23 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2.1 | 0 | 1.8 |
| 0 | 6.18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 3.3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.73 | 0 |
| 5.5 | 0 | 0 | 7.92 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0 | 11.85 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 0 | 0.77 | 1.8 | 0 | 0.33 | 0 | 0 | 0 | 0.3 | 0.6 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 0 | 6.97 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.55 |
| 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 9.1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 1.7 | 0 | 0.57 | 0 | 1.8 | 0 | 0 | 0 | 0.5 | 1 |
